**R E P U B L I K A  E  S H Q I P Ë R I S Ë**

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

DREJTORIA E MONITORIMIT TË PROGRAMEVE TË TRANSPARENCËS

Nr. 1600 Prot                                                                                    Tiranë, më 3.10.2023

Lënda: Mbi detyrimet sipas ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe ligjit nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik"

**KRYETARIT TË BASHKISË BELSH**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK BELSH**
**Belsh**
**KRYETARIT TË BASHKISË BERAT**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK BERAT**
**Berat**
**KRYETARIT TË BASHKISË BULQIZË**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK BULQIZË**
**Bulqizë**
**KRYETARIT TË BASHKISË CËRRIK**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK CËRRIK**
**Cërrik**
**KRYETARIT TË BASHKISË DELVINË**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK DELVINË**
**Delvinë**
**KRYETARIT TË BASHKISË DEVOLL**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK DEVOLL**
**Devoll**
**KRYETARIT TË BASHKISË DIBËR**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK DIBËR**
**Peshkopi**
**KRYETARIT TË BASHKISË DIMAL**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK DIMAL**
**Dimal**
**KRYETARIT TË BASHKISË DIVJAKË**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK DIVJAKË**
**Divjakë**
**KRYETARIT TË BASHKISË DROPULL**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK DROPULL**
**Jorgucat**
**KRYETARIT TË BASHKISË DURRËS**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK DURRËS**
**Durrës**
**KRYETARIT TË BASHKISË ELBASAN**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN**
**Elbasan**

**KRYETARIT TË BASHKISË FIER**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK FIER**
**Fier**
**KRYETARIT TË BASHKISË FINIQ**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK FINIQ**
**Finiq**
**KRYETARIT TË BASHKISË FUSHË-ARRËZ**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK FUSHË-ARRËZ**
**Fushë-Arrëz**
**KRYETARIT TË BASHKISË GJIROKASTËR**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK GJIROKASTËR**
**Gjirokastër**
**KRYETARIT TË BASHKISË GRAMSH**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK GRAMSH**
**Gramsh**
**KRYETARIT TË BASHKISË HAS**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK HAS**
**Has**
**KRYETARIT TË BASHKISË HIMARË**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË**
**Himarë**
**KRYETARIT TË BASHKISË KAMËZ**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK KAMËZ**
**Kamëz**
**KRYETARIT TË BASHKISË KAVAJË**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK KAVAJË**
**Kavajë**
**KRYETARIT TË BASHKISË KËLCYRË**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK KËLCYRË**
**Këlcyrë**
**KRYETARIT TË BASHKISË KLOS**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK KLOS**
**Klos**
**KRYETARIT TË BASHKISË KOLONJË**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK KOLONJË**
**Ersekë**
**KRYETARIT TË BASHKISË KONISPOL**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK KONISPOL**
**Konispol**
**KRYETARIT TË BASHKISË KORÇË**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK KORÇË**
**Korçë**
**KRYETARIT TË BASHKISË KRUJË**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK KRUJË**
**Krujë**
**KRYETARIT TË BASHKISË KUÇOVË**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK KUÇOVË**
**Kuçovë**
**KRYETARIT TË BASHKISË KUKËS**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK KUKËS**
**Kukës**
**KRYETARIT TË BASHKISË KURBIN**

**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK KURBIN**
**Laç**
**KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK LEZHË**
**Lezhë**
**KRYETARIT TË BASHKISË LIBOHOVË**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK LIBOHOVË**
**Libohovë**
**KRYETARIT TË BASHKISË LIBRAZHD**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK LIBRAZHD**
**Librazhd**
**KRYETARIT TË BASHKISË LUSHNJË**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK LUSHNJË**
**Lushnjë**
**KRYETARIT TË BASHKISË MALËSI E MADHE**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK MALËSI E MADHE**
**Koplik**
**KRYETARIT TË BASHKISË MALIQ**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK Maliq**
**Maliq**
**KRYETARIT TË BASHKISË MALLAKASTËR**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK MALLAKASTËR**
**Ballsh**
**KRYETARIT TË BASHKISË MAT**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK MAT**
**Burrel**
**KRYETARIT TË BASHKISË MEMALIAJ**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK MEMALIAJ**
**Memaliaj**
**KRYETARIT TË BASHKISË MIRDITË**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK MIRDITË**
**Rrëshen**
**KRYETARIT TË BASHKISË PATOS**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK PATOS**
**Patos**
**KRYETARIT TË BASHKISË PEQIN**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK PEQIN**
**Peqin**
**KRYETARIT TË BASHKISË PËRMET**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK PËRMET**
**Përmet**
**KRYETARIT TË BASHKISË POGRADEC**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC**
**Pogradec**
**KRYETARIT TË BASHKISË POLIÇAN**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK POLIÇAN**
**Poliçan**
**KRYETARIT TË BASHKISË PRRENJAS**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK PRRENJAS**
**Prrenjas**
**KRYETARIT TË BASHKISË PUKË**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK PUKË**

**Pukë**
**KRYETARIT TË BASHKISË PUSTEC**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK PUSTEC**
**Pustec**
**KRYETARIT TË BASHKISË ROSKOVEC**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK ROSKOVEC**
**Roskovec**
**KRYETARIT TË BASHKISË RROGOZHINË**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK RROGOZHINË**
**Rrogozhinë**
**KRYETARIT TË BASHKISË SARANDË**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK SARANDË**
**Sarandë**
**KRYETARIT TË BASHKISË SELENICË**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK SELENICË**
**Selenicë**
**KRYETARIT TË BASHKISË SHIJAK**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK SHIJAK**
**Shijak**
**KRYETARIT TË BASHKISË SHKODËR**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR**
**Shkodër**
**KRYETARIT TË BASHKISË SKRAPAR**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK SKRAPAR**
**Çorovodë**
**KRYETARIT TË BASHKISË TEPELENË**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK TEPELENË**
**Tepelenë**
**KRYETARIT TË BASHKISË TROPOJË**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK TROPOJË**
**Bajram Curri**
**KRYETARIT TË BASHKISË VAU I DEJËS**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK VAU I DEJËS**
**Vau i Dejës**
**KRYETARIT TË BASHKISË VLORË**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK VLORË**
**Vlorë**
**KRYETARIT TË BASHKISË VORË**
**KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK VORË**
**Vorë**

Të nderuar,

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka për objektiv konsolidimin e praktikave më të mira në kuadër të misionit të saj për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për të drejtën e informimit, mbrojtjen e të dhënave personale si dhe njoftimin dhe konsultimin publik, duke u përpjekur që përmes aktiviteteve të ndryshme të ketë një ndikim të prekshëm në shoqëri dhe autoritetet publike.

Zyra e Komisionerit, në kuadër të detyrave të saj funksionale monitoron faqet zyrtare të të gjitha autoriteteve publike, përfshirë këtu dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore (NJVV),

për sa i përket publikimit dhe përditësimit të Programit të Transparencës si dhe realizimit të procesit të njoftimit dhe konsultimit publik sipas parashikimeve ligjore.

Nga monitorimet e vazhdueshme të kryera nga Zyra e Komisionerit, si dhe nga raportet periodike të shoqërisë civile dhe medias të cilat gjithashtu monitorojnë transparencën e NJVV si dhe procesin e njoftimit të konsultimit publik, vlerësojmë t'ju përcjellim dy shqetësime kryesore të cilat duhet të adresohen nga Kryetarët e Bashkive dhe Këshilli Bashkiak.

Shqetësimi i parë ka të bëjë me faqen zyrtare të NJVV në të cilën duhet të publikohen sipas detyrimit ligjor, Programi i Transparencës si dhe të gjitha procedurat ligjore si dhe njoftimet përkatëse për konsultimet publike për projekt aktet e parashikuar në legjislacionin përkatës, kryesisht të ligjit nr. 119/2014, ligjit nr. 146/2014, dhe ligjit nr. 139/2015.

Shqetësimi i dytë i referohet vetë procesit të njoftimit dhe konsultimit publik nga ana e Këshillit Bashkiak i cili duhet të koordinohet me administratën e Bashkisë dhe veçanërisht me Koordinatorin për Njoftimin dhe Konsultimin Publik.

Veçanërisht neni 15 i ligjit nr. 139/2015 citon që NjVQV-të garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë dhe që çdo akt i organeve (këshillit bashkiak dhe kryetarit të bashkisë) të NjVQV-ve publikohet në faqen zyrtare të internetit të NjVQV-së dhe kjo në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi për të drejtën e informimit, ndërkohë neni 16 i këtij ligji citon se organet e NjVQV-të janë të detyruara të garantojnë pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes dhe në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi për njoftimin dhe konsultimin publik.

Për sa më sipër, në zbatim të nenit 7 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe nenit 21 të ligjit nr. 146/2014 "Për njoftimin e konsultimit publik", Zyra e Komisionerit kërkon angazhimin tuaj për të çuar përpara misionin e garantimit të zbatimit të legjislacionit për të drejtën e informimit dhe legjislacionin për njoftimin dhe konsultimin publik pjesë e procesit të integrimit evropian të vendit, duke ju garantuar qytetarëve shqiptarë standarde akoma edhe më të larta në ushtrimin praktik të të drejtave të tyre kushtetuese.

Bazuar në sa më sipër, Zyra e Komisionerit ju rikujton në cilësinë e autoriteteteve publike mbi detyrimet që burojnë nga zbatimi i ligjeve të sipërcituara, me qëllim marrjen e masave për përmbushjen e tyre. Konkretisht:

- Garantimin e mbarëvajtjes së faqes zyrtare të Bashkisë ku të publikohet/përditësohet programi model i transparencës i NJVV, sipas modelit të miratuar nga zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- Përmbushjen e detyrimit për caktimin e koordinatorit për të drejtën e informimit dhe koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik si dhe përfshirjen e këtij të fundit në procesin e njoftimit dhe konsultimit publik nga ana e Këshillave Bashkiakë.

Për t'ju ardhur në ndihmë, Zyra e Komisionerit ka përgatitur dhe një Udhërrëfyes për transparencën proaktive të autoriteteve publike të cilin e gjeni bashkëlidhur.

Përsa më sipër, në vijim dhe të detyrave funksionale, Zyra e Komisionerit do të monitorojë përmbushjen e pikave të mësipërme dhe kërkojmë të informohemi sa më shpejt lidhur me:

- Konfirmimin e publikimit të programit të transparencës në faqen zyrtare të Bashkisë;
- Konfirmimin e të dhënave të koordinatorit për të drejtën e informimit si dhe koordinatorin për njoftimin dhe konsultimin publik.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**




# Rekomandim për zbatimin e programit institucional të transparencës

TË AUTORITETEVE PUBLIKE

## 1 Objekti dhe Qëllimi

Ky rekomandim përcakton rregulla të detajuara për zbatimin e detyrimit të publikimit të informacionit me karakter publik, nga autoritetetet publike në faqen zyrtare të internetit.

Rregullat e parashikuara në këtë rekomandim kanë për qëllim garantimin e njohjes së qytetarëve me informacionin publik pa kërkesë, në mënyrën më të thjeshtë dhe më të plotë të mundshme referuar ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", (në vijim LDI).

## 2 Fushëveprimi

Rregullat e përcaktuara në këtë rekomandim, zbatohen për të gjitha autoritetet publike sipas përkufizimit në pikën 1 të nenit 2 të ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit" .

## 3 Faqja zyrtare e Autoritetit Publik

Autoriteti publik bën publik në faqen zyrtare në internet aktivitetin e tij. Faqja e internetit të autoriteteve publike duhet të konceptohet dhe organizohet në mënyrë që publiku të konsultojë me lehtësi informacionin dhe të ofrojë lundrim miqësor në tërësinë e tij. Çdo autoritetit publik duhet të publikojë në faqen zyrtare minimalisht programin e transparencës sipas parashikimeve të LDI-së veçanërisht të neneve 4, 5, 6 si dhe të zbatojë modelin e programit të transparencës të miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

## 4 Programi i Transparencës

Ikona e Programit të Transparencës duhet të vendoset në një pozicion të dukshëm dhe lehtësisht të aksesueshëm, në ballinën e faqes, pranë menuve kryesore. Në brendësi të rubrikës "Programi i Transparencës" autoriteti publik publikon në formate lehtësisht të kuptueshme dhe aksesueshme modelin e miratuar nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

## 5 Përmbajtja e informacionit

Autoriteti publik detyrohet të publikojë menjëherë çdo informacion publik të prodhuar apo të mbajtur prej tij (në programin e transparencës sipas kategorive përkatëse), çdo herë që ky informacion pëson ndryshime.
Informacioni publik pa kërkesë duhet të jetë: i plotë, i saktë, i përditësuar, i thjeshtë në konsultim, i kuptueshëm, lehtësisht i aksesueshëm dhe i pajtueshëm me dokumentet origjinale. Përpara publikimit të informacionit autoriteti publik vlerëson nësë ka ndonjë kufizim ligjor në përputhje me nenin 17 të LDI-së.

WWW.IDP.AL

## 6 Përgjegjësia, metodat, dhe formati i publikimit të informacioneve

Përgjegjësia administrative për vënien në zbatim të programit institucional të transparencës është e titullarit të autoritetit publik me përjashtim të rasteve kur titullari e ka deleguar këtë kompetencë tek nëpunësi më i lartë civil, sipas klasifikimit të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar.
Programi institucional i transparencës miratohet, publikohet dhe përditësohet sipas modelit të miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Informacionet mblidhen nga struktura të ndryshme të Autoritetit Publik dhe i dërgohen për publikim personit - strukturës përgjegjëse për publikimin e informacionit në faqen zyrtare të autoritetit publik.

Informacioni i publikuar në Programin e Transparencës në faqen zyrtare të internetit të autoriteteve publike duhet të ketë menyra alternative që të aksesohet edhe nga personat që nuk dëgjojnë dhe personat që nuk shikojnë.

## 7 Frekuenca e publikimit

Periudha kohore e publikimit dhe e përditësimit të informacionit publik në programin e transparencës është menjëherë pas finalizimit nga struktura përgjegjëse për miratimin e tij. Për sa i përket akteve ligjore e nënligjore ato publikohen pas hyrjes në fuqi apo botimit të tyre në fletoren zyrtare.

Në çdo rast, në faqen zyrtare vendoset data e përditësimit të fundit të informacionit.

## 8 Detyrimi për zbatim

Ky rekomandim ju vjen në ndihmë autoriteteve publike për të qartësuar procedurat e publikimit në faqet e internetit të kategorive të informacionit /dokumentacionit të parashikuar në nenin 7 të LDI-së.

WWW.IDP.AL

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Kreu Autoriteti Informacione Publikime Programi i Transparencës Kontakt

# Rekomandim për zbatimin e programit institucional të transparencës

TË AUTORITETEVE PUBLIKE

## 1 Objekti dhe Qëllimi

Ky rekomandim përcakton rregulla të detajuara për zbatimin e detyrimit të publikimit të informacionit me karakter publik, nga autoritetetet publike në faqen zyrtare të internetit.

Rregullat e parashikuara në këtë rekomandim kanë për qëllim garantimin e njohjes së qytetarëve me informacionin publik pa kërkesë, në mënyrën më të thjeshtë dhe më të plotë të mundshme referuar ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", (në vijim LDI).

## 2 Fushëveprimi

Rregullat e përcaktuara në këtë rekomandim, zbatohen për të gjitha autoritetet publike sipas përkufizimit në pikën 1 të nenit 2 të ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit" .

## 3 Faqja zyrtare e Autoritetit Publik

Autoriteti publik bën publik në faqen zyrtare në internet aktivitetin e tij. Faqja e internetit të autoriteteve publike duhet të konceptohet dhe organizohet në mënyrë që publiku të konsultojë me lehtësi informacionin dhe të ofrojë lundrim miqësor në tërësinë e tij. Çdo autoritetit publik duhet të publikojë në faqen zyrtare minimalisht programin e transparencës sipas parashikimeve të LDI-së veçanërisht të neneve 4, 5, 6 si dhe të zbatojë modelin e programit të transparencës të miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

## 4 Programi i Transparencës

Ikona e Programit të Transparencës duhet të vendoset në një pozicion të dukshëm dhe lehtësisht të aksesueshëm, në ballinën e faqes, pranë menuve kryesore. Në brendësi të rubrikës "Programi i Transparencës" autoriteti publik publikon në formate lehtësisht të kuptueshme dhe aksesueshme modelin e miratuar nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

## 5 Përmbajtja e informacionit

Autoriteti publik detyrohet të publikojë menjëherë çdo informacion publik të prodhuar apo të mbajtur prej tij (në programin e transparencës sipas kategorive përkatëse), çdo herë që ky informacion pëson ndryshime.
Informacioni publik pa kërkesë duhet të jetë: i plotë, i saktë, i përditësuar, i thjeshtë në konsultim, i kuptueshëm, lehtësisht i aksesueshëm dhe i pajtueshëm me dokumentet origjinale. Përpara publikimit të informacionit autoriteti publik vlerëson nësë ka ndonjë kufizim ligjor në përputhje me nenin 17 të LDI-së.

WWW.IDP.AL

Kreu Autoriteti ⌄ Informacione ⌄ Publikime ⌄ Programi i Transparencës ⌄ Kontakt

## 6 Përgjegjësia, metodat, dhe formati i publikimit të informacioneve

Përgjegjësia administrative për vënien në zbatim të programit institucional të transparencës është e titullarit të autoritetit publik me përjashtim të rasteve kur titullari e ka deleguar këtë kompetencë tek nëpunësi më i lartë civil, sipas klasifikimit të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar.
Programi institucional i transparencës miratohet, publikohet dhe përditësohet sipas modelit të miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Informacionet mblidhen nga struktura të ndryshme të Autoritetit Publik dhe i dërgohen për publikim personit - strukturës përgjegjëse për publikimin e informacionit në faqen zyrtare të autoritetit publik.

Informacioni i publikuar në Programin e Transparencës në faqen zyrtare të internetit të autoriteteve publike duhet të ketë menyra alternative që të aksesohet edhe nga personat që nuk dëgjojnë dhe personat që nuk shikojnë.

## 7 Frekuenca e publikimit

Periudha kohore e publikimit dhe e përditësimit të informacionit publik në programin e transparencës është menjëherë pas finalizimit nga struktura përgjegjëse për miratimin e tij. Për sa i përket akteve ligjore e nënligjore ato publikohen pas hyrjes në fuqi apo botimit të tyre në fletoren zyrtare.

Në çdo rast, në faqen zyrtare vendoset data e përditësimit të fundit të informacionit.

## 8 Detyrimi për zbatim

Ky rekomandim ju vjen në ndihmë autoriteteve publike për të qartësuar procedurat e publikimit në faqet e internetit të kategorive të informacionit /dokumentacionit të parashikuar në nenin 7 të LDI-së.

WWW.IDP.AL

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE